



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

**KONCEPTI PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR
ZHVILLIM 2030**

PRISHTINË, SHTATOR 2020

Përmbajtja

I. Përmbledhje e përgjithshme	3
II. Përcaktimi i prioriteteve strategjike	4
III. Strategjia e re Kombëtare për Zhvillim 2030	5
Struktura e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030	6
Fuqizimi i sistemit përmes Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik	8
IV. Strukturat e punës për hartimin e SKZH 2030	11
V. Miratimi, konsultimi dhe monitorimi i SKZH 2030	12
Shtojca 1: Kalendari i Punës për përgatitjen e SKZH 2030	14

I. Përmbledhje e përgjithshme

Që nga shpallja e pavarësisë, Kosova ka bërë një përparim të dukshëm në ndërtimin e institucioneve dhe zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të saj. Pozita gjeografike si nyje e ndërlidhjes rrugore në Ballkanin Perëndimor dhe përparësitë krahasimore të saj, e bëjnë Kosovën një vend mjaft të lakmueshëm për zhvillimin të biznesit. Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshëm mbetet një nga sfidat kryesore të vendit. Varfëria në shkallë të lartë e një pjese të popullsisë, papunësia shumë e lartë, pagat e ulëta, shërbimet shëndetësore jocalësore, ndërhyrja e politikës në drejtësi, siguria juridike dhe drejtësia e vonuar, mjedisi i papastër, shfrytëzim i ulët i pasurive natyrore, arsimi jocalësor, migrimi dhe ngecje të tjera në aspekte të tjera sektoriale, e bëjnë jetesën e qytetarëve dhe mjedisin biznesor më të vështirë dhe më sfidues.

Pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim shumë të madh në rënien edhe më të lartë të aktivitetit ekonomik dhe remitançave. Si pasojë e pandemisë, pritet të rritet edhe më shumë niveli i papunësisë, duke mos përjashtuar ndikimin tek punëtorët në tregun e ekonomisë joformale, ku si pasojë do të ulen të ardhurat dhe do të ulet fuqia blerëse. Ndërsa si pasojë e rënies së remitançave, do të ulet konsumi familjar, duke e shfaqur kështu rrezikun e rritjes së nivelit të varfërisë. Prandaj, duke i marrë parasysh këto, është paraqitur nevoja e menjëhershme për një strategji afatgjate, ku planifikohet rimëkëmbja dhe përballja ndaj sfidave dhe dëmeve të shkaktuara nga COVID-19, si dhe përmes të cilit do të planifikohet qasja ndaj sfidave, dëmeve dhe pengesave kryesore të zhvillimit në vend.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 (SKZH 2030) do të jetë dokumenti kryesor strategjik i cili do të ofrojë vizionin për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, qasjen ndaj zgjidhjeve të problemeve dhe kahjen e politikave strategjike dhe buxhetore të vendit për një afat dhjetë vjeçar, e cila do të jetë e bashkërenduar me ndihmat e huaja, kreditë shtetërore dhe planet për investime publike. SKZH 2030 do të përmbajë shtyllat e saj të zhvillimit, të cilat adresojnë sfidat dhe pengesat kryesore të vendit, duke u fokusuar në zhvillim ekonomik, mirëqenie sociale, arsim cilësor, mjedis të pastër, siguri juridike dhe institucione efektive.

Prandaj, për adresimin sa më të mirë të sfidave dhe pengesave në këto fusha, SKZH 2030 do të përmbajë objektivë strategjikë, objektivë specifikë dhe tregues të matshëm të ndikimit, duke mos u lëshuar në nivel operativ. Objektivet e SKZH 2030 do të ndërlidhen me agjendën e integritimit evropian, Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe me Agjendën e Gjelbër (Green Deal). Zbatimi dhe monitorimi i saj do të bëhet nëpërmjet strategjive sektoriale dhe planeve institucionale për të siguruar lidhje më të mirë me buxhetin e shtetit. Rrjedhimisht, objektivi specifik i SKZH 2030, do të jetë një objektiv strategjik i strategjisë përkatëse sektoriale, e cila do të zërthehet në veprime konkrete operative me kode fikse buxhetore. Planifikimi i tillë strategjik do të mundësoj dhe lehtësoj zbatimin dhe monitorimin sa më të mirë të SKZH 2030, si dhe do të përmirësojë sistemin e planifikimit strategjik në tërësi, duke e transformuar atë aktual në sistem me qasje të integruar të planifikimit.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto që u theksuan më lartë, në mënyrë që të jetë sa më e kompletuar në vizionin e saj, SKZH 2030 do të diskutohet me të gjitha palët e interesit, përfshi

partnerët strategjikë të vendit, akterët politikë, sektorin privat dhe shoqërinë civile. Diskutimi dhe konsultimi i tillë është mjaft i rëndësishëm, duke e pasur parasysh se SKZH 2030 është dhe duhet të jetë një konsensus i gjerë në nivel vendi. Prandaj, kjo qasje gjithëpërfshirëse dhe integruese sa i përket përmbajtjes, hartimit, zbatimit dhe monitorimit, përveç tjerash, do të ndikojë edhe në përmirësimin e planifikimit dhe organizimit institucional, buxhetimit të duhur dhe në të menduarit analitik dhe strategjik, që si rrjedhojë e lehtëson zbatimin e SKZH 2030 dhe arrijtjen e objektivave të parapara për zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

II. Përcaktimi i prioritetëve strategjike

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 do të përcaktojë vizionin për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit në dekadën e ardhshme. Sfidat, pengesat dhe ngeçjet në zhvillim janë identifikuar dhe do të identifikohen vazhdimisht duke u bazuar në përvojën institucionale dhe raportet e analizat vendore dhe ndërkombëtare, siç janë ato të Bankës Botërore (EB), Fondit Monetar Ndërkombëtar (IMF), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Komisionit Evropian (KE), etj.

Përkundër faktit që në vitin 2019 Kosova pati një rritje ekonomike prej 4.2%, ekonomia pritet të zvogëlohet deri në 5% në vitin 2020, në shërbime dhe investime si pasojë e pandemisë COVID-19. Kosova përballet me një përqindje të lartë të varfërisë dhe papunësisë. Pas situatës së shkaktuar nga COVID-19, kjo përqindje pritet të ketë rritje të konsiderueshme. Në anën tjetër, vetëm 6.1% të PBB-së shpenzohen për mbrojtje sociale. Sa i përket punësimit, ekonomia joformale është një çështje tjetër shqetësuese, e cila ndodh, mes tjerash, si pasojë e efikasitetit të ulët dhe mungesës së bashkëpunimit të duhur ndër-institucional. Në fushën e shëndetësisë, gjendja është jo e kënaqshme, duke pasë parasysh infrastrukturën e dobët dhe mungesën e pajisjeve adekuate profesionale e cila përcillet me një kujdes jo të duhur shtetëror, duke shpenzuar vetëm rreth 1.6% të PBB për shëndetësi. Rrjedhimisht, rreth 40% të shpenzimit për kujdes shëndetësor i bartin vet qytetarët e vendit, e cila është shqetësuese duke marrë parasysh edhe rënien e remitancave, për shkak të pandemisë COVID-19.

Një rënie tjetër pritet të ndodhë në Investimet e Huaja Direkte dhe tregtisë ndërkombëtare. IHD-të aktualisht përbëjnë 7% të PBB (kjo si pasojë e investimeve nga diaspora, kryesisht në patundshmëri) të cilat priten të bien përgjysmë gjatë vitit 2020. Tregtia zë 85% të ekonomisë, ndërsa importet 55% të PBB. Shërbimet tregtare arrijnë 60% të PBB duke zënë 35% të punësimit formal, mirëpo varësia e lartë e importit dhe performanca e dobët e eksportit, kanë ndikuar në deficite të larta tregtare dhe llogarisë rrjedhëse, të cilat rrezikojnë të zgjerohen edhe më shumë për shkak të gjendjes pandemike. Në anën tjetër, investimet private dhe publike pritet të ulen për shkak të vështirësive financiare dhe kufizime buxhetore të shkaktuara nga pandemia. Në këtë kontekst, për rritur nivelin e potencialit investues, një vëmendje e konsiderueshme duhet t'i kushtohet sektorëve të energjisë, bujqësisë, industrisë prodhuese dhe transportit. Impiantët e vjetra të energjisë, diversiteti i ulët i burimeve të energjisë dhe përdorimi joefikas i saj, mjedisi i papastër, shfrytëzim i ulët i pasurive natyrore, mirëmbajtja jo e duhur e rrugëve, gjendja e dobët e linjave hekurudhore dhe mungesa e rezervave hekurudhore, prodhimtaria e ulët në bujqësi dhe

kostoja e lartë e prodhimit, fragmentimi i tokës bujqësore, infrastruktura e dobët e ujitjes, teknologjia e vjetruar, mospërputhshmëria e nevojave të tregut me përgatitjet profesionale, etj., përbëjnë shqetësim të madh për vendin, të cilat ndikojnë potencialin investues, rritjen e punësimit dhe në jetën e qytetarëve.

Sfida të tjera serioze mbeten në fushën e arsimit, sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Cilësia e dobët arsimore dhe mospërputhja e arsimimit me nevojat e tregut të punës, përbënë një shqetësim tjetër serioz. Përveç aspekteve që hyjnë në kuadër të mirëqenies sociale, aspekte tjera që ndikojnë në cilësinë e dobët janë mungesa e infrastrukturës së duhur fizike, mosfinancimi i duhur, mungesa e licencimit të institucioneve private dhe mungesa e profesionalizmit të duhur të edukatorëve, mungesa e pajisjeve teknologjike, etj. Ndërsa, sa i përket fushës së sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, probleme shqetësuese mbeten siguria juridike dhe drejtësia e vonuar, mungesa e kornizës së duhur ligjore, zbatimi jo i duhur i ligjit, grumbullimi i lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykata, niveli i lartë i korrupsionit dhe krimin të organizuar lidhja e drejtësisë me politikën, niveli i lartë i ekonomisë joformale, barra e lartë administrative, disiplina e ulët e administratës, gjendja jo e mirë e rregullatorit tatimor në Kosovë, etj.

Duke i pasë parasysh të gjitha këto detaje të analizave dhe raporteve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe analizat tjera përgjatë procesit në diskutim dhe konsultim të vazhdueshëm me të gjithë akterët relevantë, do të përcaktohen objektivat strategjike të SKZH 2030, procesi i cili do të shpjegohet në pjesën pasuese.

III. Strategjia e re Kombëtare për Zhvillim 2030

Strategjia ekzistuese për zhvillim konsiderohet si dokumenti kryesor planifikues dhe pjesa më e madhe dokumenteve planifikuese bazohen në shtyllat dhe masat e saj. Megjithatë, një sërë sfidash e karakterizojnë kornizën ekzistuese strategjike të cilat duhet të adresohen. SKZH ekzistuese nuk përfaqëson të gjitha sfidat dhe objektivat e rëndësishme zhvillimore të vendit, ndërsa e tërë korniza ekzistuese strategjike lëngon nga mungesa e hierarkisë së objektivave, qëndrueshmërisë matëse të performancës, caqeve, etj., ndërmjet SKZH 2030 dhe dokumenteve të tjera planifikuese afatgjata dhe afatmesme. Duke e pasë parasysh këtë, në kontekstin e nevojës për të adresuar mangësitë ekzistuese, inicimi i SKZH 2030, përveç adresimit të sfidave dhe ngecjeve të cilat u theksuan më lartë dhe përcaktimit të prioriteteve për zhvillim afatgjatë të vendit për të planifikuar transformimin ekonomik dhe daljen nga ndikimi i shkaktuar nga pandemia COVID-19, ajo do të shërbejë edhe si një mekanizëm për të avancuar sistemin ekzistues të planifikimit në një Kornizë Kombëtare të Menaxhimit Strategjik.

SKZH 2030 do të shërbejë si dokumenti kryesor strategjik me një fokus afatmesëm në rimëkëmbjen nga ndikimi i COVID-19 në situatën socio-ekonomike të vendit. Si i tillë SKZH do të shërbejë si mekanizëm për zbatimin e vizionit strategjik për një periudhë afatgjatë, përmes përcaktimit të prioriteteve zhvillimore, objektivave strategjike dhe rezultateve që pritet të arrihen. Zbatimi i këtij vizioni duhet të kontribuojë në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim të vendit në strukturat e Euro-Atlantike, dhe njëkohësisht përkushtimin për zbatimin dhe integrimin e

Synimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG). Është me rëndësi të theksohet se SKZH e re do të shërbejë si një mekanizëm i rëndësishëm për Kosovën sa i përket perspektivës së re financiare të BE-së, të zbatuar përmes IPA III. Hartimi i saj dhe përgatitjet për të, do të japin kontributin për reagimin strategjik për IPA III, të cilat do të zhvillohen paralelisht. Kjo është një përparësi për rishikimin e ndërmjetëm të saj.

Struktura e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030

Për nga struktura, SKZH 2030 do të ndjek qasjen përmes katër shtyllave të cilat në fakt përbëjnë elementet kryesore të pengesave për zhvillimin e vendit, siç u theksuan edhe më lartë në pjesën parapake. Kjo qasje do të shërbejë si bazë përgjatë procesit për elaborimin e prioriteteve të reja për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik. Prandaj, për të adresuar sfidat e zhvillimit të vendit dhe për vendosur një qasje gjithëpërfshirëse, SKZH 2030 të ndërtohet mbi katër shtylla tentative, si në vijim:

- I. Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë;
- II. Rritja e qëndrueshme ekonomike;
- III. Kapitali njerëzor dhe shoqëria e barabartë; dhe
- IV. Mjedisi i pastër dhe burimet e qëndrueshme.

Në këto katër shtylla, do të përfshihen të gjithë sektorët e zhvillimit, ku do të ofrohet një analizë e gjendjes aktuale dhe drejtimi për zhvillim përmes një numri të objektivave strategjike dhe treguesve korrespondues. Ajo do të përcaktojë objektivat kombëtare të zhvillimit, çështjet horizontale ndër-sektoriale që lidhen me një numër sektorësh dhe objektivat specifike të zhvillimit për secilin sektor. Politikat ndër-sektoriale të politikave do të organizohen si agjenda horizontale. Qasja e tillë do të adresojë nevojën për planifikim gjithëpërfshirës dhe të integruar, si dhe përcakton një kornizë të qartë të planifikimit për 10 vitet e ardhshme.

Sektorët	Shtyllat e SKZH 2030			
	I Rritja e qëndrueshme ekonomike	II Kapitali njerëzor dhe shoqëri e barabartë	III Mjedisi i pastër dhe burimet e qëndrueshme	IV Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë
	Objektivi Strategjik: Rritja e Punësimit Zhvillim i NMV-ve Konektiviteti Infrastrukturë e qëndrueshme Ekonomia digjitale (AH) ¹	Objektivi Strategjik: Qasja dhe cilësia e shërbimeve Barazi për të gjithë Identitet kulturor Shoqëria digjitale (AH)	Objektivi Strategjik: Parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjes Shfrytëzim i qëndrueshëm i burimeve Mbrojtja e biodiversitetit (AH)	Objektivi Strategjik: Efektiviteti Cilësia Transparenca Qasja në drejtësi Qeveria digjitale (AH)

¹ Agjendat Horizontale – shih fq.8 sqarimet tek Definimi i llojeve dhe hierarkisë së dokumenteve strategjike

Qeverisja dhe administrata publike	Zvogëlimi i barrës administrative.	Qasje e barabartë në shërbimet e institucioneve qendrore dhe lokale.	Transpozimi i direktivave të BE-së për fushën e mjedisit.	Modernizimi i AP E- qeverisja
Financat publike	Lufta kundër punësimit joformal E-mbledhja e taksave.			Planifikimi dhe shpenzimi efektiv.
Politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare	Tërheqja e investimeve nga Diaspora	Mundësitë për punësim për të rinjtë nga Diaspora.		Integrimet euroatlantike.
Mbrojtja dhe siguria				Fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal.
Siguria Publike		Minoritete të sigurta.	Parandalimi dhe mbrojtja nga zjarret.	Menaxhimi i integruar i kufirit.
Drejtësia		Qasje e barabartë në drejtësi.		Fuqizimi i sistemit ligjor.
Mjedisi			Menaxhimi efektiv i mbeturinave. Mbrojtja e biodiversitetit.	
Transporti dhe komunikimi	Transporti multi-modal. Infrastruktura e internetit (AH).	Qasje në shërbimin e transportit për personat me aftësi të kufizuara.	Zvogëlimi i ndotjes nga transporti.	
Energjia	Prodhimi dhe furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike		Burimet e ripërtëritshme. Ndërtesa me energji efijente.	
Mbështetje për industrinë dhe biznesin	E-biznesi Zhvillimi i sektorit të TIK (AH) Mbështetje për eksportin dhe tregtinë.		Përdorimi efijent i energjisë në industri.	
Kultura dhe koha e lirë	Zhvillimi i industrive kulturore.	Diversiteti kulturor dhe trashëgimia kulturore.	Mbrojtja e trashëgimisë natyrore.	
Punësimi dhe Tregu i Punës	Kapaciteti dhe cilësia e shërbimeve të punësimit.			
Kujdesi Social		Sistem i qëndrueshëm dhe i përballueshëm i benefiteve.		
Shëndetësia	Siguria në punë	E-shëndeti (AH)		

Arsimi dhe Shkenca	HZHI për biznese Balancimi i arsimit me kërkesën e tregut të punës.	Cilësia e arsimit në shkolla Kompetencat në TIK dhe zhvillimi i shkathtësive (AH)		Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të shërbyesve civilë.
---------------------------	--	--	--	--

Fuqizimi i sistemit përmes Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik

SKZH 2030 do të jetë dokumenti i parë i cili do të hartohet dhe do të vendos bazamentin për Kornizën për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik (KPMS). Kjo qasje mundëson dhe përcakton dy elemente të rëndësishme të reformës. Ajo përcakton bazën për vendosjen e hierarkisë së objektivave dhe treguesve të performancës, si dhe definimin e kufijve të sektorëve sipas klasifikimit të funksioneve të qeverisë (COFOG), duke mundësuar kështu një lidhje më të qëndrueshme me planifikimin buxhetor, monitorimin dhe raportimin e saj. SKZH 2030 kështu do të ofrojë një bazë solide për përgatitjen e KASH-it ku do të ndërliken të gjithë sektorët sipas COFOG dhe për formulimin të aktiviteteve me kode identike përmes futjes në zbatim të planeve institucionale nga Organizatat Buxhetore (OB).

• DEFINIMI I LLOJEVE DHE HIERARKISË SË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Duke u bazuar në analizën e kornizës ekzistuese strategjike, dhe përvojat e deritanishme, më qëllim të definimit të llojeve dhe hierarkisë së dokumenteve strategjike, është propozuar struktura në vijim:

- *Strategjia Kombëtare për Zhvillim* – është dokument strategjik afatgjatë që do të përfshijë të gjithë sektorët. Siç është theksuar më lartë, SKZH do të përfshijë vizionin afatgjatë kombëtarë, që duhet të përcaktoj synimet e zhvillimit kombëtar, çështjet horizontale të rëndësishme për sektorë të ndryshëm, caqe specifike zhvillimore për secilin sektorë, duke vendosur kështu bazën për përgatitjen e KASH-it.
- *Agjendat horizontale* - dokumente përmes të cilave koordinohen agjenda të caktuara qeveritare përmes të cilave orientohen të gjitha përpjekjet/intervenimet që i dedikohen një çështje apo grupi të synuar të trajtuar përgjatë të gjithë sektorëve ekzistues. Agjendat horizontale nuk duhet të konsiderohen si dokumente alternative planifikuese, por si mekanizëm koordinues dhe monitorues. Prioritetet ose objektivat e përbashkëta horizontale duhet të diskutohen dhe dakordohen në kuadër të SKZH.
- *Strategjitë sektoriale* dhe planeve të tyre të veprimit, veprime të cilat, përmes kodeve do të ndërliken me të gjitha dokumentet planifikuese. Duke u bazuar në vlerësimin e kornizës ekzistuese strategjike, një ose më tepër strategji mund të zhvillohen për një sektor, varësisht nga struktura e sektorit dhe përmbajtja e objektivave. Strategjitë sektoriale, duhet të:
 - Vendosin kornizën për përcaktimin e veprimeve konkrete dhe planifikimin e veprimeve të organizatave buxhetore në KASH dhe Planin Vjetor të Punës;
 - Përcaktoj treguesit kryesor të rezultetit për vlerësimin e progresit
 - Ofroj një pikëpamje gjithëpërfshirëse se do të zbatohen objektivat strategjike të SKZH-së brenda secilit sektorë, dhe sigurojnë një qasje të integruar, qëndrueshme dhe të balancuar për zhvillimin e sektorit

- Ofroj informata mbi ndikimin afatgjatë të strategjisë specifike sektoriale në financa publike dhe mundësinë e vlerësimit të përballueshmërisë të masave të propozuara për buxhetin.
- *Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë*, që lëshohet për një periudhë 3 vjeçare dhe që ndërlidhet me prioritetet e vendit të përcaktuara në SKZH.
- *Plani i Punës së Qeverisë* - Plani i Punës i Qeverisë (PPQ) është dokumenti i cili paraqet se si programi qeveritar do të zbatohet në nivelin operativ. Ky plan nga viti 2019 mbulon periudhën tre vjeçare, ku viti i parë paraqet veprimet konkrete të ministrive, kurse dy vitet pasuese veprime indikative.

Agjenda e Integritimit Evropian - Dokumentet e hartuara në kuadër të Agjendës Evropiane, siç janë PRE dhe PKZMSA, kanë një vend specifik në hierarkinë e dokumenteve të planifikimit strategjik. Ato duhet të konsiderohen më tepër si një burim informacioni për të vendosur objektiva specifike ose për të futur masa dhe aktivitete specifike në dokumentet kombëtare. Duke qenë se ky dokument përbënë qasjen për plotësimin e kriterëve për anëtarësim në BE, por edhe bazë të fortë për fuqizuar shtetin ligjor dhe demokratik, mirëqenien e qytetarëve dhe ekonominë e vendit. Në kuadër të kësaj, duhet të theksohet nevoja për *harmonizimin e prioriteteve kombëtare me perspektivën e re financiare të BE-së*. Me këtë nënkuptohet ndërlidhja e agjendës së integritimit evropian, prioriteteve kombëtare të përcaktuara në SKZH dhe strategji sektoriale, duke përfshirë edhe strategjitë e partnerëve të tjerë zhvillimor.

KASH nuk duhet të konsiderohet si një dokument i planifikimit strategjik me objektiva alternative. Është dokumenti që synon të sigurojë stabilitetin dhe transparencën e shpenzimeve publike dhe duhet të hartohet bazuar në masat dhe aktivitetet e planifikuara në dokumentet strategjike kombëtare.

PËRKUFIZIMI I SEKTORËVE TË BAZUAR NË COFOG

Duke u bazuar qasjen e praktikuar në planifikimin buxhetor si dhe raportimin e ekzekutimit të buxhetit të Kosovës, është bërë një vlerësim mbi vendosjen e qasjes sektoriale në sistemin e planifikimit strategjik në Kosovë. Struktura e sektorëve duhet të përdoret për përcaktimin e drejtimit afatgjatë të politikave dhe së dyti duhet të lidhet ngushtë atë që njihet si struktura e klasifikimit të shpenzimeve publike (COFOG). Gjithashtu, përkufizimi i sektorëve duhet të bazohet në ndarjen e qartë të kufijve të sektorit, si dhe në ndryshimin në mes të sektorit dhe çështjeve horizontale. Si rrjedhojë, është propozuar definimi i sektorëve dhe është prezantuar numri dhe titujt e sektorëve të mundshëm, sic mund të shihet në tabelën për strukturën e SKZH-së. Duke qenë se kufijtë se sektorit mund të lidhen me grupet e COFOG (në nivelin 2, dhe kur është e mundur në nivelin 1), dhe rrethanat dhe karakteristikat e vendit është propozuar definimi i sektorëve, duke përfshirë numrin dhe titujt e sektorëve të mundshëm. Sic shihet në Tabelën 1 për strukturën e SKZH-së, më lartë, procesi i SKZH-së do të shërbejë për dakordimin dhe definimin e kufijve të sektorit.

KASKADA E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Objektivat do të vendosen në formë kaskade, me anë të cilit objektivat dhe prioritetet e nivelit të lartë të vendosura në SKZH 2030, do të detajohen më tej në dokumentet e nivelit më të ulët, respektivisht në strategjitë sektoriale. Kaskadimi nëpër të gjitha nivelet e futjes së planifikimit

strategjik deri në nivelin operativ, do të mundësoj buxhetimin e planifikimit të aktiviteteve të organizatave buxhetore. Ndarja e qartë e nivelit të planifikimit strategjik (kombëtar, sektorial dhe institucional) lejon vendosjen e të gjitha objektivave të dokumenteve strategjike (kombëtare/strategjike, specifike/sektoriale, institucionale, ndër-sektoriale, etj.) në një sistem të qartë hierarkik vertikal dhe për të vendosur lidhje midis objektivave afatgjatë, afatmesëm dhe vjetor. Kjo siguron ekuilibrin e qëndrueshmërisë së objektivave strategjike afatgjatë dhe fleksibilitetin e zbatimit në nivelin afatmesëm dhe në atë operacional. Kështu, do të gjendet vendi i duhur (funksional) për Programin e Qeverisë dhe Planin e Punës (PPQ) në KPMS.

Zbatimi i kaskadës është një parakusht për krijimin e një kornize të qartë referimi të performancës me një numër të kufizuar të objektivave strategjike kombëtare dhe objektivave për secilin sektor, treguesve të matshëm dhe hierarkisë së qartë të dokumenteve përkatëse strategjike.




Figura 1 Tabela me kaskadën e objektivave strategjike dhe treguesve

NDËRLIDHJA ME KORNIZËN AFATMESME TË SHPENZIMEVE DHE BUXHETIN VJETOR

Në kuadër të Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik do të sigurohet gjithashtu vendosja e dy elementeve: a) aktiviteteve me formulim fiks dhe kode identike dhe b) planet institucionale.

- a) **Aktivitetet me formulim fiks dhe kode identike** - Kodet fikse për aktivitetet për përmbushjen e objektivave strategjike dhe specifike, që do të korrespondojnë, në nivel të veprimeve operative, me formulim fiks të aktiviteteve me kodet e tyre buxhetore, të cilat do të barten në të gjitha dokumentet e planifikimit, respektivisht në planet e veprimit të

strategjive sektoriale, Planin e Punës së Qeverisë, propozimin e buxhetit, etj. Në këtë formë, aktiviteti shihet si element ndërlidhës ndërmjet dokumenteve strategjike, PRE, KASH dhe buxhetit vjetor.

- b) **Planet institucionale** – që nuk nënkupton nivel të ri planifikimit apo dokument të ri, por propozimin dhe ndryshimin e formave ekzistuese të procesit të planifikimit të buxhetit. Si i tillë, do të shërben si një mjet për planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve të organizatave buxhetore për një periudhë afatmesme (3 vjeçare).

Plani institucional mund të shërbejë si një dokument ndërmjet planifikimit strategjik dhe formatit të planifikimit të buxhetit, duke transferuar "aktivitetet" nga një format në tjetrin. Kjo lejon lidhjen e objektivave strategjikë të dala nga dokumentet strategjike me përdoruesit e veçantë të buxhetit në sektor dhe me shpenzimet reale të planifikuara në KASH / buxhetin vjetor. Plani institucional do të përdoret për planifikimin, raportimin dhe menaxhimin e funksionimit të OB-ve. Ai do të paraqesë një burim të vetëm informacioni për shumë dokumente të tjera të planifikimit në nivel më të lartë (p.sh.: PPQ, PRE, PKZMSA, etj.) Pritet që planet institucionale të krijojnë një parakusht për thjeshtimin e aranzhimeve të monitorimit dhe uljen e barrës administrative për OB-të.

IV. Strukturat e punës për hartimin e SKZH 2030

Duke marrë parasysh që procesi i hartimit të SKZH 2030 është i gjatë dhe kërkon një bashkëpunim të madh midis institucioneve, përfshirë këtu edhe partnerët strategjikë, funksionet dhe përbërja e strukturave të punës të parashikuara në Udhëzimin Administrativ (07/2018) duhet të zgjerohen, por përgjegjësia për menaxhimin e procesit dhe vendimmarrjen vazhdon të bazohet në rregullat dhe procedurat e planifikimit strategjik kombëtar.

Komisioni për Planifikim Strategjik (KPS) është përgjegjës për udhëheqjen e procesit të planifikimit të politikëbërjes strategjike përpara vendimmarrjes përfundimtare nga Qeveria. KPS do të jetë organi i përkohshëm i vendimmarrjes në procesin e hartimit të SKZH 2030. Në këtë proces, KPS do të jetë përgjegjës për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit strategjik kombëtar dhe objektivave kombëtare, për aprovimin e çështjeve dhe prioriteteve sektoriale dhe ndër-sektoriale (horizontale), vendosjen e kornizës makroekonomike për zbatimin e strategjive dhe përcaktimin e burimeve kryesore të financimit të zbatimit të SKZH 2030. Po ashtu, është me rëndësi të veçantë se KPS do të sigurojë përfshirjen e Kryeministrit dhe të nivelit më të lartë të vendimmarrjes në procesin të hartimit të SKZH 2030.

Ekipi Kombëtar për hartimin e SKZH është përgjegjës për hartimin e SKZH 2030, do të përcaktojë prioritetet strategjike afatgjata dhe afatmesme tentative të sektorëve në vend dhe do t'i paraqesë ato për miratim në KPS. Ekipi kombëtar përbëhet nga Grupi i Përgjithshëm (GP) dhe Grupet e Punës Tematike (GPT).

Grupi i Përgjithshëm është përgjegjës për rishikimin e strukturës përfundimtare të SKZH 2030, përpara se ta dërgojnë për rishikim në KPS, rishikimin e objektivave dhe treguesve specifikë të SKZH 2030, rishikimin e prioriteteve afatgjata dhe afatmesme për zhvillimin kombëtar, përpara

se të kalohet në KPS, duke marrë parasysh financimin e BE-së, buxhetin kombëtar dhe burime të tjera të financimit, rishikimin e prioriteteve horizontale dhe rishikimin e agjendave horizontale, rishikimin përfundimtar të SKZH 2030 dhe paraqitjen e saj për rishikim në KPS. Grupi i Përgjithshëm do të kryesohet nga Kryesuesi i Grupit Drejtues të Planifikimit Strategjik (GDPS) dhe një këshilltar politik i emëruar nga Kryeministri.

Grupet e punës tematike janë përgjegjëse për analizimin, rishikimin, propozimin dhe përpilimin e analizave bazuar në sektorë brenda secilës temë, si dhe identifikimin e sfidave dhe problemeve për sektorët dhe propozimin e objektivave strategjikë për adresimin e tyre brenda sektorit.

Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) do të shërbejë si Koordinator i Ekipit Kombëtar gjatë gjithë procesit të hartimit të SKZH 2030.

V. Miratimi, konsultimi dhe monitorimi i SKZH 2030

Konsultimet e brendshme dhe publike të SKZH 2030 do të organizohen sipas rregullave në fuqi. Në lidhje me konsultimet e brendshme, Zyra për Planifikim Strategjik do ta paraqesë SKZH 2030 si një projekt të konsoliduar për komente, përpara miratimit. Do të mbahen takime të nivelit të lartë me ministrat për të marrë konfirmimin e ministrave për objektivat, treguesit dhe synimet që kanë të bëjnë me secilin sektor dhe ministri. Si pjesë e konsultimeve publike të jashtme, ZPS do të organizojë takime konsultative për të diskutuar draftin e SKZH 2030 me bizneset, OJQ-të, ndërmarrjet publike dhe palët e tjera të interesuara, duke i ftuar ata të marrin pjesë në takimet e grupit punues tematik, organizimin e diskutimeve të hapura publike, prezantimin e objektivave të SKZH 2030 dhe rezultateve të pritura, vlerësimin e informatave kthyesë dhe rregullimin e SKZH 2030. Procesi i konsultimit do të finalizohet në fund të tetorit 2021 dhe prezantimi i projektit të SKZH 2030 për aprovim në Qeveri do të jetë në nëntor 2021. Kjo do të pasohet nga publikimi i SKZH 2030 dhe mbajtja e ngjarjes së lansimit të saj në fillim të dhjetorit 2021.

Meqenëse SKZH 2030 do të jetë dokumenti kryesor i planifikimit strategjik afatgjatë (10-vjeçar) i Kosovës dhe do të përfshijë të gjithë sektorët e politikave, monitorimi i zbatimit të saj do të bëhet me anë të zbatimit të strategjive sektoriale dhe planeve të punës. Siç është theksuar dhe ilustruar më lartë, SKZH 2030 nuk do të lëshohet në nivel operativ, mirëpo do të përmbajë objektivet strategjikë dhe objektivet specifike. Rrjedhimisht, një objektiv specifik i SKZH, do të jetë një objektiv strategjik i strategjisë së caktuar sektoriale, e cila do të zërthehet në veprime konkrete operative. Në këtë mënyrë, monitorimi i zbatimit të saj, do të jetë më i lehtë dhe më i saktë.

Përveç kësaj, si dokumenti kryesor i planifikimit strategjik dhe ndarjes buxhetore, planet e punës dhe veprimet tjera në nivel të ministrave do të ndërliken vazhdimisht me objektivet e SKZH 2030, përmes KASH-it dhe buxhetit vjetor. Kjo për dy arsye: së pari, objektivet strategjikë të SKZH 2030 do të maten me makro tregues për temat dhe sfidat kyçe në vend, të cilat vazhdimisht diskutohen nga akterët politikë, partnerët strategjikë dhe shoqëria civile, për t'i adresuar dhe përmirësuar ato. Këto tema dhe sfida do të arrijnë identifikimin në SKZH 2030 nga analizat e shumta të jashtme dhe të brendshme, si dhe nga përfshirja e akterëve më relevantë për temat dhe sfidat e trajtuara. Së dyti, qëndrueshmëria e planifikimit strategjik përmes qasjes së integruar të

planifikimi strategjik, vendosjes së rezultateve të ndikimit tek të gjitha dokumentet strategjike dhe lidhja e këtij planifikimi me buxhet përmes kodeve fikse buxhetore të objektivëve dhe veprimeve operative, do të imponojë dhe ndihmoj zbatimin e objektivëve të SKZH 2030 dhe arritjen e treguesve të tyre.

Prandaj, duke marrë parasysh këtë, monitorimi i zbatimit të SKZH 2030, do të jetë përmes qasjes integruese, nga poshtë lartë, ku do të përfshihen të gjitha organizatat buxhetore me anë të mekanizmave institucional të monitorimit, respektivisht planeve institucionale dhe raporteve periodike. Më pas, të gjitha raportet mblidhen, analizohen dhe organizohen nga Zyra për Planifikim Strategjik, e cila e harton raportin gjithëpërfshirës të zbatimit të SKZH 2030 dhe të njëjtin e dërgon në strukturat për planifikim strategjik për shqyrtim dhe intervenim, respektivisht në Grupin Drejtues për Planifikim Strategjik dhe Komisionin për Planifikim Strategjik. Këto raporte, mes tjerash, do të paraqesin arritjen e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm (SDG), objektivave të Agjendës së Gjelbër (Green Deal), si dhe pasqyrat e vështirësive dhe sfidave kryesore në zbatim, siç janë, mes tjerash, edhe financimi, procedurat prokuruese, mosmarrëveshjet institucionale, etj., për të cilat mund të merret vendim në KPS dhe Qeveri.

Si përfundim, qasja e re e hartimit dhe qasja e re integruese e monitorimit të zbatimit të SKZH 2030, do të ndikojë në përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e planifikimit strategjik në vend, buxhetimit të duhur dhe efektiv, zvogëlimin e procedurave raportuese institucionale, si dhe në të menduarit analitik dhe strategjik.

Shtojca 1: Kalendar i Punës për përgatitjen e SKZH 2030

Fazat

	Zyra për Planifikim Strategjik	Institucioni përgjegjës	Koha
Faza1: Parapërgatitja dhe vendosja e strukturave për hartim të SKZH 2030	(I) Vlerësimi i sistemit të planifikimit strategjik dhe hartëzimi i strategjive sektoriale re (e kryer).	ZPS	Qersh 2020
	(II) Hartimi i Konceptit të SKZH, diskutimi në Grupin Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) (e kryer).	ZPS	Qersh-Shtat 2020
	(III) Miratimi i Konceptit dhe vendimit për fillimin e të hartimit të SKZH-së.	KPS	Java e 3-të e shtatorit 2020
	(IV) Miratimi i vendimit për fillimin e procesit të hartimit SKZH 2030.	Qeveria	Java e 4-të e shtatorit 2020
Faza 2: Definimi i problemeve, sfidave dhe pengesave për zhvillim të vendit	(I) Përfundimi i studimit “Rishikimi Shumëdimensional i Vendit – nga OECD për vendet e Ballkanit Perëndimor”, si analizë fillestare për gjendjen aktuale të vendit.	ZPS	Tetor 2020
	(II) Krijimi i tabelës fillestare SËOT (sipas sektorëve, dhe i integruar) në bazë të analizës ekzistuese, mbledhja e të dhënave statistikore përkatëse dhe treguesve.	ZPS	Tetor-fillimi i Nëntorit 2020
	(III) Shpërndarja e draft tabelës sektoriale të SWOT tek grupet përkatëse të punës/ministritë për komente dhe propozime, mbledhja e informatave dhe komenteve potenciale(feedback).	ZPS dhe GT	Nëntor 2020
	(IV) Punëtori për GT, për kryerjen dhe finalizimin e SWOT.	ZPS	Nëntor 2020
	(V) Analiza e inputeve, përcaktimi preliminar i pengesave dhe sfidave kryesore të zhvillimit.	ZPS	Nëntor 2020

Faza 3. Ndërlidhja me Integrimet Evropiane, OZHQ-të dhe proceset tjera ndërkombëtare

(VI) Identifikimi preliminar i sfidave dhe pengesave për zhvillim	KPS	Gjysma e parë e Dhjetor 2020
(I) Analiza e ndërlidhjes së OZHQ-ve të KB me sfidat dhe objektivat për zhvillim të vendit, ndërlidhja e SKZH 2030 me OZHQ-të.	ZPS, GT	Dhjetor 2020
(II) Analiza e ndërlidhjes së objektivave të politikës së kohezionit të BE 2021-2027 dhe objektivave të IPA me sfidat dhe objektivat për zhvillim të vendit.	ZPS	Dhjetor 2020
(III) Analiza e rëndësisë së politikave të tjera të ndihmës donatore shumëpalëshe dhe dypalëshe për objektivat e zhvillimit të Kosovës.	ZPS	Dhjetor 2020
(I) Hartimi i propozimit për objektivat kombëtare të SKZH 2030, treguesve të ndikimit dhe vlerave të tyre për shtyllat përkatëse.	ZPS, GDPS - Diskutim i objektivave.	Dhjetor 2020
(II) Zhvillimi i një kornize financiare indikative dhe burimeve financiare për zbatimin e SKZH 2030 - vlerësimi i burimeve të mundshme financiare (të brendshme dhe të jashtme) në dispozicion për zbatimin e SKZH 2030.	ZPS, GDPS - diskutimi i ekuilibrit ndërmjet ambicieve strategjike dhe burimeve.	Dhjetor 2020
(III) Diskutim me partnerët kryesorë për zhvillim, BE dhe donatorë të tjerë në lidhje me pengesat dhe sfidat e zhvillimit të vendit, objektivat strategjikë, ndërlidhjet me politikat e ndihmës së donatorëve për të zbatuar SKZH 2030.	ZPS, GP	Janar 2021
(IV) Hartimi i propozimit për përcaktimin e agjendave horizontale (AH). Dakordimi i listës së agjendave horizontale.	GDPS	Janar 2021
(V) Miratimi i objektivave strategjike kombëtare dhe synimeve (targeteve) të treguesve, kornizës financiare indikative dhe listës së agjendës horizontale.	KPS	Janar 2021

Faza 5: Zhvillimi i objektivave specifike sektoriale që korrespondojnë me shtyllat dhe objektivat kombëtare, përgatitja për konsultime publike e SKZH 2030.

(I) Hartimi i propozimit për grupin e objektivave për secilin sektor dhe treguesit përkatës.	ZPS/GDPS	Shkurt 2021
(II) Përgatitja e udhëzimeve për GPT për formulimin e objektivave sektoriale dhe përcaktimi i synimeve të treguesve.	ZPS	Shkurt 2021
(III) Hartimi i objektivave sektoriale dhe treguesve për secilin sektor nga GPT-të.	ZPS, GPT	Shkurt 2021
(IV) Marrëveshja për numrin dhe listën e dokumenteve strategjike sektoriale të nevojshme, duke hartuar listën përfundimtare të strategjive që duhen mbajtur brenda SKZH 2030.	GPT - propozime në listën e strategjisë për sektorë.	Shkurt 2021
(V) Përgatitja e draftit të SKZH 2030 për miratim në KPS.	ZPS/GDPS	Mars 2021
(VI) Miratimi i tekstit të SKZH (që përmban objektivat strategjike (për shtyllat) dhe specifike (për secilin sektor) dhe treguesit përkatës me listën e dokumenteve strategjike zbatuese (strategjitë sektoriale dhe agjendat horizontale) për SKZH 2030.	KPS	Mars 2021
Faza 6. Diskutim publik me partnerët kryesorë socio-ekonomikë.		
(I) Shpërndarja e draft dokumentit të SKZH 2030 tek palët e interesuara si dhe publikimi në platformën për konsultime publike për komente me shkrim.	ZPS	Prill 2021
(II) Prezantimi i draftit të SKZH 2030 tek palët e jashtme të interesit (Takimi i përbashkët i palëve të interesit).	ZPS	Prill 2021
(III) Diskutim publik, prezantimi i objektivave të SKZH-së dhe rezultatet e pritura.	ZPS me pjesëmarrje të GDPS	Prill - Maj 2021
(IV) Shqyrtimi i komenteve dhe ndryshimi i SKZH 2030, sipas nevojës nga komentet e marra. Finalizimi i tekstit të SKZH 2030.	ZPS/GDPS	Prill-Maj Shkurt 2021
(V) Sipas nevojës, miratimi i SKZH-së me ndryshime nga KPS.	KPS – Miratimi i SKZH-së	Maj 2021

Faza 7. Miratimi i SKZH 2030 publikimi dhe lansimi i zbatimit	(I) Prezantimi i draftit të SKZH 2030 për aprovim në Qeveri	ZPS	Maj-Qershor 2021
	(II) Miratimi, publikimii SKZH 2030 dhe mbajtja e ngjarjes së lansimit të SKZH 2030	Qeveria	Maj-Qershor 2021
Faza 8. Përpunimi i Agjendave Horizontale dhe rishikimi i strategjive sektoriale	(I) Përpunimi i modeleve për hartimin e AH, përcaktimi i institucioneve udhëheqëse (koordinuese) për AH dhe rregullat e zbatimit të AH për përfshirjen në strategjitë sektoriale.	Udhëhequr nga ZPS	Të përcaktohet në vendimin e Qeverisë për miratimin e SKZH.
	(II) Emërimi i institucioneve përgjegjëse për hartimin / rishikimin e secilës strategji sektoriale sipas listës së optimizuar brenda SKZH 2030, përcaktimi i modeleve, orarit dhe mbështetjes për hartimin ose rishikimin e tyre.	Udhëhequr nga ZPS	Të përcaktohet në vendimin e Qeverisë për miratimin e SKZH.

